

Syllabusi i lëndës

Lënda: FIK'H III - *E drejta civile*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4

Statusi i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 305

Fondi i orëve: 2+2

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: V

Mësimdhënësi: Dr. Ilmije Kuqi

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Kjo lëndë ka të bëjë me shitblerjen, format e saj lexhitime, llojet e saj, format apo mënyrat e ndaluara të shitblerës, si mashtrimi, shitblerja e gjërave të ndytura, shitblerja me dhunë apo inponim, etj. Pastaj komata, llojet e saj, efektet ansore dhe në shoqëri. Pastaj e drejta apo mundësia për ta anuluar atë shitblerje, etj. Pastaj disa forma të biznesit si, ortakria, llojet e saj, veqoritë e secilit llojë të ortakrisë etj...

Qëllimi i lëndës

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka shitblerja, kontratat, format dhe mënyrat e saj, në jetën e qytetarit, ngase njeriu si krijesë sociale ka nevojë për tjetrin, ka nevojë për atë që posedon tjetri, e kjo arrihet në forma të ndryshme, si me dhuratë, huazim, falje, shitblerje, pastaj anulim të asaj shitblerjeje, mënyra e përdorimit të asaj pasurie që është huazuar, falur, pastaj autorizim, lënie hipotekë dhe forma tjera të cekura në këtë kontekst. Pastaj myslimani është shumë i kujdesshëm që pasurinë e tjetrit mos ta shfrytëzoj apo nga ajo mos të përfitoj vetëm se në mënyrë legjitime. E për të qenë i sigurt në tërë këtë, vije në kjo lëndë dhe rëndësia e saj për ti sqaruar të gjitha ato dispozita, për ti argumentuar me fakte, në mënyrë që myslimani të jetë syçelë në dinin e tij. E kjo tregon për madhësinë e kësaj feje dhe gjithëpërfshirjen e të gjitha segmenteve të jetës së tij.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj lënde studenti arrin deri tek njohja e mendimeve të katër shkollave juridike në lidhje me temat në fjalë, e që është një madhësi në vete dhe pasuri e madhe.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të lëndës, shpresojmë të studentit të jetë në gjendje:

Të pajiset me njohuri mjaft të detajuar rreth kësaj lënde, respektivisht të drejtës civile Islame.

Të jetë në gjendje edhe t'iu shpjegoj dhe sqaroj të tjerëve rreth temave të elaboruara.

Të jetë në gjendje edhe ta mbroj mendimin e përzgjedhur duke e argumentuar atë me fakte, ashtu siç veprojnë juristët islam.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, nxitjes së studentëve për debat dhe diskutime interaktive, përmes seminareve dhe hulumtimit të literaturës së re e cila lidhet ngushtë me natyrën e lëndës. Do të bëhen edhe teste vlerësuese të kohëpaskohshme dhe punë grupore me studentë për tema të caktuara.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Njohja me lëndën , rëndësinë dhe peshën e saj, qëllimin e saj, pastaj njohja me sollabusin, pastaj me literaturën , me metodologjin e spejgimit, të notimit e kështu me radhë.

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/15-80)

Java e dytë: Shitblerja, definicioni i saj, ligjshmëria e saj, shtyllat e saj, kushtet e saj, llojet e saj..

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/89-92)

Java e tretë: Shitblerja e imponuar, shitblerja mbi shitblerje, , shitblerja e ujit. Shitblerja e gjërave hallall nga frika se përdoren në haram, shitblerja dy personave. Shitblerja e mallit të vjedhur. Shitblerja në xhami

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/101-102)

Java e katërt: Shitblerjet e ndaluara, shitblerja e urrejtur, shitblerjen jo valide, shitblerja e gjërave të ndyta, apo ndyrësirave. Shitblerja e ujit, shitblerja e qenit.

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/102-109)

Java e pestë: E drejta e përzgjedhjes, e drejta e përzgjedhjes në kuvend, e drejta e vendosjes së kushtit, e drejta e përzgjedhjes për të metën.

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/118-131)

Java e gjashtë: caktimi i çmimit, kufizimi në fitim, monopolizimi i tregut, ryshfeti.

Kufizimi (Ndalimi i kompetencave ligjore), përkufizimi, ligjshmëria dhe dispozita e kufizimit, urtësia e legjitimitetit të kufizimit, ndarja e kufizimit sipas llojit të dobisë, a kufizohet i vështirësuarit? Kujdestari dhe kushtet e tij, shkëmbimet e kujdestarit, kufizimi për interes të përgjithshëm, largimi i kufizimit ndaj të kufizuarve.

Literatura: (Fihu Hanefi 2/407-421)

Java e shtatë: kollekfiumi i parë.

Literatura:

Java e tetë: Paraqitja e rezultateve dhe sqarim rreth pyetjeve e përgjigjeve të kollekfiumit. Shitblerja me parapagim (beju selem), definicioni, ligjshmëria e saj kushtet e saj,

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/122-125)

Java e nëntë: Kamata; përkufizimi i saj, dispozita e saj, kronologjia e ndalimit të kamatës, urtësia e ndalimit të kamatës, llojet e kamatës; kamata e shtesës dhe vonesës, bankat dhe kamata, funksionimi i bankave islame.

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/125-130)

Java e dhjetë: Pengu, përkufizimi i tij, dispozita dhe ligjshmëria e tij, urtësia e legjitimitetit të pengut, pjesët përbërëse për vlefshmërinë e pengut, kushtet për vlefshmërinë e pengut, përfitimi nga pengu.

Uzurpimi, përkufizimi i tij, përfitimi nga prona apo gjësendi i uzurpuar, mbrojtja e pasurisë nga uzurpuesi.

Literatura: (Fihu Hanefi 3/341-359)

Java e njëmbëdhjetë: Huazimi, përkufizimi i tij, ligjshmëria e tij, urtësitë e lejimit të kësaj dispozite, koha e kthimit të huas, dëmtimi apo hargjimi i gjësendit të huazuar. Huazimi i gjësendit të huazuar.

Lënia e gjësendit amanet, ligjshmëria e tij, përfitimi nga gjërat e lëna amanet. Dallimi mes huazimit dhe gjësendit të lënë amanet. Falja, dispozita e tij, kur ai që fal diçka kërkon ta rikthen serish ish pronën e tij.

Literatura: (Fihu Hanefi 2/537-543)

Java e dymbëdhjetë: Borxhi, ligjshmëria e tij, koha e kthimit të borxhit. Shterja e borxhit edhe për një afat të caktuar. Dallimi mes borxhit, mes huazimit dhe mes gjësendit të lënë amanet.

Autorizimi, përkufizimi,, përfaqësimi, dispozita dhe ligjshmëria e tij, pjesët përbërëse të autorizimit, kushtet e autorizimit, autorizimi i kushtëzuar me kusht dhe me kohë, autorizimi për konflikte, dëmshpërblimi, mbarimi i kontratës së autorizimit.

Literatura: (Fihu Hanefi 2/609-628)

Java e trembëdhjetë: Gjetja e një sendi , një pasurie të humbur, çka duhet të bëjë me te, përfitimi nga ai gjësend i gjetur.

Gjetja e foshnjës-fëmiut të braktisur, çka duhet të bëjë me te, çfarë të drejte ka ndaj asaj foshnje Nëse i dihet apo nuk i dihen prindi? I humburi, apo i zhdukuri. Sa duhet pritur atë për ta ndarë pasurinë e tij, çka të bëhet dhe si të veprohet me tregtinë apo ortakërinë që ka pasur dikush me te?

Kontrata për mbjellje, përkufizimi i saj, ligjshmëria, kushtet e kësaj kontrate. Dhënia e tokës me qira në të holla.

Kontrata për ujitje, përkufizimi i saj, ligjshmëria, kushtet e kësaj kontrate.

Literatura: (Fihu Hanefi 2/387-402)

Java e katërbëdhjetë: Partneriteti (ortakëria), ligjshmëria e ortakërisë, urtësia e ortakërisë, pjesët përbërëse të ortakërisë, llojet e ortakërisë, ortakëria e pabarabartë, ortakëria e barabartë, ortakëria në zanat, ortakëria me pozitë, prishja e kontratës së ortakërisë. Sigurimet bashkëkohore, ligjshmëria e tyre.

Literatura: (Legjislacioni i traditës së Profetit 3/208-216)

Java e pesëmbëdhjetë: Vakëfi, ligjshmëria e tij, llojet e tij, përfitim i nga vakëfi, ndryshimi i vakëfit. Vasieti apo testamenti, ligjshmëria e tij, sasia e testamentit, kur hynë në fuqi testamenti, testamenti për trashëgimtarin e pasurisë.

Përfundim e lëndës dhe gjithpërmbledhje

Literatura: (Fihu Hanefi 2/509-533, 2/351-358)

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, *Fikhu Hanefi në veshjen e re*, fondacioni i rinisë islame Zurich 2012
2. Sejis dabik , *Legjislacioni i traditës së Profetit*. Mileniumi i Ri ,Tiranë, 2007

Literatura konsultative:

1. Grupë dijetarësh, *Shpjegim i shkurtër i Legjislaturës Islame*. Shkup, 2008
2. Vehbetu Zuhejl, *El-Vexhiz Fi El-Fikh El-Islamij*, Dara El-Fikr Damask 2007 botimi i dytë.
3. El-Mejdani, *El-Lubab Fi Sherh El-Kitab*, Dar Tiba Damask.